

Drejtoria Arsmore e Filadelfias

Klasa e Kopshtit, Udhëzues për Prindërit

Zyra e Programeve Akademike dhe Shkollore

Parent Study Guide for kindergartners (Albanian)

Leximi/Shkrimi

Në fund të vitit shkollor, nxënësit e kopshtit do të jenë të aftë të:

- Flasin rreth personazheve dhe ti vendosin ato në një tregim, të cilën ata e kanë dëgjuar apo lexuar.
- Ritregojnë një pjesë sipas rendit të leximit apo dëgjimit.
- Përdorin figurat dhe fjalët për të kuptuar një tregim.
- Të lexojnë sëpaku 50 fjalë që përsëriten në shumë tregime si ran, with, us, the, etj.
- Të pikturojnë diçka dhe të shkruajnë shënime për pjesët e ndryshme të vizatimit.
- Të spellojnë saktë disa nga fjalët që ata ndeshin më shpesh në lexim apo në të folur si: are, with, play, you.
- Të kopjojnë fjalët e përditëshme që shikojnë në lagje apo pranë shtëpisë.
- Të shkruajnë fjali të shkurtëra dhe të bëjnë një listë të shkurtër të gjërave si :ushqime që ata pëlqejnë,emra të kafshve etj.



Matematikë

Në fund të vitit shkollor, nxënësit e kopshtit do të jenë të aftë të:

- Të kuptojnë dhe përdorin fjalët si: over, under, above, below, next to dhe between
- Të krahasojnë numrat (më e madhe, më e vogël, më shumë se, më pakse)
- Të përdorin objekte ose pikturat për numrat 0-20
- Të lexojnë dhe shkruajnë numrat deri në 20
- Të përdorin objekte për të numëruar, renditur, dhe grupuar sipas madhësisë, ngjyrës ose kategorisë
- Të njohin dhe emërtojnë monedhat (pennies, nickels, dimes, quarters)
- Të ndajnë pjesë të barabarta midis dy njerëzve
- Të flasin rreth motit lidhur me temperaturën dhe stinët Të bëjnë matje duke përdorur objekte, si format e drurit (blocks), kapset e letrës (paperclip) ose pulla plastike (plastic chips)
- Të përdorin objekte dhe fotografi për të treguar rreth vetes tyre dhe ambjenti
- Të njohin figurat bazë si trekëndëshi, katrori, drejtëkëndëshi dhe rrethi
- Të numërojnë me zë nga 1-50

Shkencë

Në fund të vitit shkollor, nxënësit e kopshtit do të jenë të aftë të:

- Të përshkruajnë ndryshimet e motit sipas stinëve, si psh. moti i ngrrohtë në verë dhe i ftohtë në dimër
- Të përdorin shqisat (të parit, të nuhaturit, të shijuarit, të prekurit, dhe të dëgjuarit) për të zbuluar rreth vetes dhe mjedisit rrotull tyre
- Të grupojnë dhe përshkruajnë objekte sipas përbërjes tyre (formës, përbërjes, madhësisë, peshës, ngjyrës, përmbajtjes dhe lëvizjes)
- Të zhvillojnë ndjenjën e respektit dhe kuptimit për jetën, si bimët dhe kafshët
- Të kryejnë kërkime shkencore duke punuar individualisht dhe në grup



Studime Sociale

Në fund të vitit shkollor, nxënësit e kopshtit do të jenë të aftë të:

- Spjegojnë si individët, familjet dhe grupet kanë ngjashmëri dhe dallime.
- Japin fakte rreth historisë Afrikano-Amerikane.
- Kuptojnë që njerëzit dhe vendet ndryshojnë me kalimin e kohës.
- Kuptojnë dhe diskutojnë faktin, që të gjitha familjet kanë nevoja jetësore bazë.
- Përqëndrohen në zhvillimin e një qëndrimi pozitiv ndaj vetes, familjes dhe të tjerëve.



Edukim Fizik/Shëndetësor

Në fund të vitit shkollor, nxënësit e kopshtit do të jenë të aftë të:

- Të flasin rreth shëndetit personal dhe të praktikojnë zakone të mira për shëndetin. Të njohin ushqimet e shëndetshme dhe rëndësinë e vaktit të mëngjesit
- Të identifikojnë raste emergjente të zakonshme; djegjen, rrëzimet, dhe prerjet
- Të njohin aktivitete që nxisin një shëndet të mirë fizik
- Të njohin të mirat e bashkëpunimit dhe kooperimit.

Art dhe Muzikë

Në fund të vitit shkollor, nxënësit e kopshtit do të jenë të aftë të:

Art

- Përdorin materiale të ndryshme artistike për të skicuar, pikturuar dhe bërë skulpturë.
- Të gjejnë objektin qëndror në një punë artistike si një person, shtëpi ose lule.
- Të japin opinionin e tyre për një punë artistike.

Muzikë

- Ecin, vrapojnë , hidhen, kërcëjnë dhe marshojnë me muzikë.
- Këndojnë ninulla dhe këngë popullore